

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pse fëmijët duhet të mësojnë të lexojnë botën me hundë – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/pse-femijet-duhet-te-mesojne-te-lexojne-boten-me-hunde/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 00:17:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	3 shtator 2026, 20:51:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e2c6bce62e72cc0e3f394ab2e9f2c97ec34abdccf2d140030c4ef38b0a80e8c0
TEKSTI	8b172a98bbfc19c55c421a96d47feab29ddce046187a162d56f16f845e9b6cd3
PAMJA	bae903eedac118bd0f55bf3cd7ccc739b8ee8d5bc25589f68acd444f2b4d5241

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d3ab0a0092237c8887cb5227d82da2e04de781b1dfdd7be03cdc290b5e507a1b
E MËPARSHMJA	a626b042a6dce12e9c292de89499c8758208ab2344c4c686d88d32b461ff5ce9
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d3ab0a0092237c8887cb5227d82da2e04de781b1dfdd7be03cdc290b5e507a1b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ushqimin, rrezikun dhe madje edhe veten. Këtë argument ngre historiani i aromave, Dr. Will Tullett, nga Universiteti i York-ut, sipas të cilit shkollat duhet t'i mësojnë fëmijët të "angazhojnë hundën" po aq natyrshëm sa mësojnë të shohin, të lexojnë apo të përshkruajnë ngjyrat.

Sipas tij, ndotja mund të dëmtojë aftësinë tonë për të nuhatur, ndërsa jeta moderne po e ndryshon në mënyrë artificiale marrëdhënien me aromat. Shumë gjëra rreth nesh, nga margarina te brendësia e makinave, madje edhe shtëpitë tona, janë zhveshur nga aroma e tyre natyrale dhe janë "riparfumosur" me aroma sintetike. Pyetja, thotë Tullett, është se çfarë i bën kjo shpërthim aromash artificiale aftësisë sonë për të dalluar nuancat e vërteta të erërave.

Ai propozon një lloj edukimi nuhatës që mund të nisë në shkollë, por edhe në shtëpi. Fëmijët mund të nxiten të nuhasin më shumë gjëra, fruta, erëza, libra, dru, tokë, ushqime, rroba, tregje, hapësira të ndryshme. Sa më shumë të nuhasim, aq më shumë pasurojmë fjalorin me të cilin përshkruajmë botën. Somelierët, kujton ai, bëjnë pikërisht këtë: ecin nëpër tregje, nuhasin gjithçka dhe ndërtojnë një arkiv kujtimesh aromatike.

Nuhatja nuk është vetëm poezi shqisore. Ajo ka edhe funksion praktik. Një shembull i thjeshtë është siguria ushqimore: aftësia për të dalluar nëse një ushqim është ende i freskët apo duhet hedhur, pa u varur vetëm nga data e skadencës. Por lidhja është edhe më e thellë. Studime të shumta kanë treguar se aftësia për të shijuar aromat lidhet fort me mirëqenien psikologjike, ndërsa humbja e nuhatjes shpesh shoqërohet me ankth, depresion dhe simptoma të tjera

5 Viti i ri shkollor nis edhe në Burgun e Korçës, 31 të dhënuar ndjekin...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

depression dhe simptoma të tjera.

Tullett kundërshton idenë se njerëzit nuk e vlerësojnë nuhatjen.

Përkundrazi, kur pyeten, ata kujtojnë menjëherë aroma të lidhura me fëmijërinë, shtëpinë, njerëzit e dashur, frikën apo humbjen. Problemi, sipas tij, është se njerëzve rrallë u jepet gjuha dhe besimi për të folur për aromat.

Në librin e tij të ri, Sniff: A History of Smells, që pritet të botohet më 8 shtator, Tullett rrëzon edhe një klishe të zakonshme: idenë se e kaluara “mbante më shumë erë”. Sipas tij, e kaluara nuk vinte më shumë apo më pak erë se e tashmja; thjesht kishte aroma të tjera.

Dhe këtu çështja bëhet më politike. Aromat, thotë ai, janë përdorur shpesh për të shënuar dallime dhe për të diskriminuar. Qiramarrës të refuzuar për shkak të paragjykimëve mbi aromat e ushqimit të tyre, të pastrehë të stigmatizuar për “erë të tepërt”, komunitete të tëra të gjykuara përmes hundës së të tjerëve.

Prandaj, sipas Tullett, duhet të jemi më të vetëdijshëm për mënyrën si i gjykojmë aromat dhe më empatikë ndaj preferencave të të tjerëve. Sepse një nuhatje e menduar mirë nuk na ndan domosdoshmërisht; mund të na ndihmojë të kuptojmë më mirë veten dhe njerëzit përreth.

Në fund, çdo epokë lë aromën e vet. Për Britaninë e shekullit XXI, Tullett përmend dezinfektuesin e duarve, zjarret dhe ndotjen e ujit. Edhe aroma nostalgjike e zjarrit me dru, paralajmëron ai, mund të ndryshojë kuptim: nga kujtim i ngrohtë shtëpie, në shenjë frike për një botë që digjet më shpesh.

#Fëmijët

#Hundë

#VizionPlus




Taulant Halili

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



LIFESTYLE

Pesë gjërat që nuk duhet t'ia tregoni...

Xhuljana
Zhuleku

34 minuta
më parë



LIFESTYLE

Horoskopi sot/ Yjet paralajmërojnë...

Xhuljana
Zhuleku

1 orë më
parë



LIFESTYLE

Kakao në kafënë e mëngjesit? Ja si mun...

Xhuljana
Zhuleku

Sot
00:48



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.